



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARDJANA A. MEDIU
ADRESA Blv.Deshmoret e Kombit,
Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7
TEL: 692041001

KONTRATË DHURIMI PASURI E

LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 3295

Nr. koleksioni: 1104

Tirane më 25/06/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2021050620127465885



A2021050620127465885

KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 30.06 /2021, para meje Notere ARDJANA A. MEDIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Blv."Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, u paraqitën personalisht:

DHURUES:

Zj.Entela Proko, atësia Kristo, amësia Suzana, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë: "Rruga e Kavajes", Nd. 55, H. 1, Ap. 1, Njësia Administrative Nr. 10, lindur më 05/08/1970, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Pasaportë Nr.BG4754476 dhe Nr. Personal H05805154B;

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")

PRANUES I DHURIMIT:

Z.Astrit Veliaj, atësia Ferik, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Rr."Jul Variboba" Vila Nr.2, lindur më 08/04/1958, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 033825706 dhe Nr.Personal F80408148C.

(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit")

Rrethanat e hartimit të aktit noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noterja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

Baza Ligjore

Neni 761 e vijues të Kodit Civil

Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar

Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Të Përgjithshme

A.Shoqëria "UTV EDUCATION" Sh.p.k, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Nr. NIPT K31531673S, date 04.06.2020.

- **Zj.Entela Proko**, zotëron kuotën që përfaqëson 100 % kapitalit në shoqëri;



A201305062627465885

Palët në perputhje me Ligjin “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” Nr. 7850 datë 29.07.1994, Ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” dhe në perputhje dhe me Statutin e Shoqërisë “UTV EDUCATION” Sh.p.k.

Kërkuan redaktimin e kontratës së dhurimit të kuotës si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Dhuruesi, **Zj.Entela Proko**, bie dakort të transferoj nëpërmjet dhurimit në total kuotën që përfaqëson **100 %** të kapitalit në Shoqërinë “UTV EDUCATION” Sh.p.k, tek Pranuesi i Dhurimit, **Z.Astrit Veliaj**, atësia Ferik, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, lindur më 08/04/1958, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Letërnjoftim ID Nr.033825706 dhe Nr. Personal F80408148C.

Neni 2

Gjendja e Kuotave

Kuota, objekti i kësaj kontrate, është plotësisht e disponueshme, e transferueshme, dhe e lirë nga çdo lloj pengu, hipoteke apo barre tjetër ligjore.

Vlera e kuotës së dhuruar është **25.383,000,00** (njëzet e pesë milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë lekë).

Neni 3

Deklarimet dhe garancitë

Dhuruesi deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Dhurimi zotëron kuotën që përfaqëson **100 %** të kapitalit në Shoqërinë “UTV EDUCATION” Sh.p.k, dhe ka të drejtën për t’a transferuar këtë kuotë dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Dhuruesi.

Pranuesi i Dhurimit deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Pranuesi i Dhurimit ka tagra të plota për të pranuar kuotën që përfaqëson **100 %** të kapitalit në Shoqërinë “UTV EDUCATION” Sh.p.k, nga Dhuruesi Zj.Entela Proko, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate Dhurimi dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Pranuesi i Dhurimit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është transferimi i kuotës që përfaqëson **100 %** të kapitalit në kapitalin e Shoqërisë “UTV EDUCATION” Sh.p.k që Dhuruesi zotëron ka efekt të menjëhershëm.

Pranuesi i dhurimit është mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve menjëhere pas nënshkrimit të këtij akti dhe regjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Transferimi i pronësisë mbi kuotën që përfaqëson 100 % të kapitalit në Shoqërinë “UTV EDUCATION” Sh.p.k, objekti i kësaj Kontrate, kryhet nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit, me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi i dhurimit gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi pjesën e tij takuese të kuotës në shoqërinë “UTV EDUCATION” Sh.p.k, të zotëruar në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.



Neni 5

Mosmarrëveshjet

Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim nga të dy palët në rast të kundërt do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 6

Gjuha e Kontrates dhe Hyrja ne Fuqi

Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të barazvlefshme dhe origjinale, dhe pasi ju lexua palëve, u nënshkrua rregullisht prej tyre në prezencën time. Akti në nënshkruhet dhe prej meje noterës.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

Dhuruesi

Zj.Entela Proko

Pranuesi i Dhurimit

Z.Astrit Veliaj

NOTERE
Ardjana A.Mediu